



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 29 Prot.

Tiranë, më 15.01.2024

VENDIM

Nr. 3 datë 15.01 2024

**“PËR
PËRCAKTIMIN E POZICIONEVE PJESË E SHËRBIMIT CIVIL QË DO TË
SHPALLEN PËR VITIN 2024, PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 147/d të Kushtetutës, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si dhe Vendimit të Kuvendit nr. 10/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”,

V E N D O S A:

1. Pozicionet pjesë e shërbimit civil që do të shpallen për vitin 2024, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, janë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

**PLANI VJETOR I PRANIMIT, PËR VITIN 2024, PËR ZYRËN E INSPEKTORIT
TË LARTË TË DREJTËSISË**

NIVELI I MESËM DHE I ULËT DREJTUES			
NR.	POZICIONI	NUMRI I POZICIONEVE VAKANTE	KATEGORIA E PAGËS
1	Ndihmës Inspektor, Njësia e Ndihmës Inspektorëve	1	II-b e barazvlefshme me klasën II-1
2	Drejtor, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse	1	II-b e barazvlefshme me klasën II-1
NIVELI ULËT DREJTUES			
1	Përgjegjës i Sektorit të Statistikës, Drejtoria e Analizës dhe Standardeve	1	III-a e barazvlefshme me klasën III-1
NIVELI EKZEKUTIV			
NR.	POZICIONI	NUMRI I POZICIONEVE VAKANTE	KATEGORIA E PAGËS
1	Specialist në Sektorin e Arkiv Protokollit, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse	1	III-b e barazvlefshme me klasën IV-1
2	Specialist në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse	1	III-b e barazvlefshme me klasën IV-1
3	Specialist në Sektorin e Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse	1	III-b e barazvlefshme me klasën IV-1

4	Specialist Prokurime në Sektorin e Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse	1	III-b e barazvlefshme me klasën IV-1
---	---	---	--------------------------------------

Shënim: Barazvlefshmëria e pagave është bërë referuar lidhjes 7/4/b të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, e ndryshuar.